

Pupu në garën e vrapimit



Për klasën e parë të arsimit fillor

Pupu në garën e vrapimit

Fjalët kyçe:

nevojat, kërkesat, dëshirat, blerja e pakontrolluar, paratë, numërimi i parave, kursimi, dhurimi, bamirësia, arka e kursimeve.

Udhëzime për punë me librin.

Para leximit: Bisedë me fëmijët:

- Kush ua blenë gjërat që ju pëlqejnë?
- A jeni penduar ndonjëherë për zgjedhjen që keni bërë? Pse?
- Ku i mbani paratë që ua dhurojnë familjarët?

Gjatë leximit: Bisedë me fëmijët:

- Nxitni fëmijët të flasnin për atë çfarë shohin në ilustrim.
- Përdorni pyetjet: Çfarë po shihni? Pse është...? Ku ...? etj.
- Pas çdo faqeje të lexuar bisedoni për atë se çfarë ka ndodhur.
- Nxitni fëmijët të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në faqen tjetër pa e shfletuar ende.
- Kërkoni nga fëmijët që të gjejnë fjalë të ngjashme me disa nga fjalët e reja në tekst.


Pas leximit: Bisedë me fëmijët:

- Shihni faqet 4 dhe 5: Si ndjehet Pupu?
- Shihni faqet 6 dhe 7: Cilat para duken këtu?
- Shihni faqet 8 dhe 9: Përse donte të vraponte Pupu?
- Shihni faqet 10 dhe 11: Përse duket i frikësuar Pupu?
- Shihni faqet 16 dh 17: Çfarë e porositi mësuesja Pupun dhe pse?
- A janë atletet, nevojë apo dëshirë e Pupus?



Në oborrin e shkollës së Pupus po mbahej një panair. Sportistët e qytetit, i kishin dhuruar shkollës pajisjet e tyre. Me të hollat që do të fitohen nga shitja e tyre, shkolla e Pupus do të bënte dhuratë për shkollën e fëmijëve me nevoja të veçanta.





**Derisa Pupu po shijonte gjithë qejf akulloren e sapo blerë,
papritmas u dëgjua zëri i mikes së tij, Mimit:**

- Pupuuuu, eja shiko atletet që të duhen ty, – e thirri ajo.
- Ah, tani nuk mund t'i blej, – u ankua Pupu.



MERR DHE DHURO



NAIRI
RÉLISE

- Këto para nuk mjaftojnë. Përse duhej ta blija akulloren e dytë?
Mësuesja që ishte aty afër e dëgjoji Pupun dhe i tha:



- Mos u shqetëso Pupu! Këto atlete nuk janë në shitje. Ato i takojnë fituesit të garës së vrapimit dhe ti ke rast t'i fitosh ato në garë. Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit e garës do të fitojnë nga një arkë kursimi.





**Pupus i shndritën sytë nga gëzimi.
- Faleminderit! Shpresoj se do t'i fitojë në garë, ndërsa këto para që i kam po i dhuroj për bamirësi, - foli Pupu gjithë shpresë.**





Derisa miushi po dremiste, Pupu po priste me padurim kohën e fillimit të garës së vrapimit.

- Unë kam vetëm 2 euro e 50 cent. A mund ta kem këtë kapelë, ju lutem? – u dëgjua një panda i vogël afër banakut.





- Sigurisht! Kapela kushton 2 euro, - buzëqeshi mësuesja.
- Me 2 euro do ta blej kapelen kurse paratë tjera dua t'i dhuroj, - vazhdoi panda i vogël.





Edhe Mimi dëshironte të blinte diçka.

- Unë kam 5 euro, çfarë mund të blej me ato? – pyeti Mimi.
- Ky top është i futbollistit tonë të qytetit dhe kushton 4 euro - shpjegoi mësuesja.



- A mund ta marr topin ju lutem? Paratë tjera dua t'i dhuroj, – tha Mimi.
- Sigurisht! Të faleminderit për dhuratën! – foli mësuesja me butësi.



- Ju faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje! Tani ju ftojme në garën e vrapimit, – u dëgjua zëri i mësueses.





Të gjithë po shikonin me interesim vrapuesit e përgatitur për garë.
- Le të filloj gara. Gatiii! 3, 2, 1. Nisuuu!!! - thirri mësuesja.





Pupu ishte duke vrapuar me shpejtësi të madhe edhe pse po e pengonin atletet e vjetra. A thua do t'ia dalë të fitoj vendin e parë?



**- Pupu, Pupu! – thërrisnin të gjithë, sapo Pupu arriti te caku.
Fytyra e Pupas shkëlqente nga gëzimi.**





**Mësuesja ia dhuroi Pupos atletet dhe arkën e kursimit si dhuratë.
- Kujdes, mos bëj blerje të shpejta. Mendo mirë çfarë të nevojitet, –
e porositi ajo.**





- Në këto arka mund të vendosni kursimet tuaja dhe do ta shihni se sa shpejt mbushet arka nëse kurseni rregullisht, – i këshilloi mësuesja Pupun dhe dy pandat tjera.





Derisa miushi po shijonte copëzën e djathit, Pupu dhe Mimi thanë njëzëri:

- Eja tani, le të luajmë me top së bashku.





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY

Titulli: "Pupu në garën e vrapimit"
Hartoi tekstin: Luljeta Rama
Ilustroi: Leopard Cana

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

0875

821.18-93-34

Rama, Luljeta

Pupu në garën e vrapimit / hartoi tekstin Luljeta Rama; ilustroi Leopard Cana. - Prishtinë:
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2020. – 20 f. : ilustr. ; 22 cm. - (Libri i parë)

1.Cana, Leopard

ISBN 978-9951-8977-4-7

E drejta e autorit i përket Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni pjesë të këtij botimi, ju lutemi të citoni burimin.
Realizimi i këtij libri u mbështet nga EFSE Departamenti për Zhvillim.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Adresa: Rr. Garibaldi, Nr. 33 Prishtinë, Kosovë.
Tel: + 383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763
e-mail: info@bqk-kos.org



Pupu në garën e vrapimit

Pupu në garën e vrapimit

Pupu shkon në bankë!

A do të shkojë Pupu në cirk?

Një ditëlindje më ndryshe!

Pupu ka një ide!

Libri i parë

www.edukimifinanciar.org

Edukimi financiar për nxënësit e klasave I-V

ISBN 978-9951-8977-4-7



9 789951 897747